



Swiss
Cultural Fund
Albania

UDHËZIME PËR APLIKUESIT

Programi i Granteve Rajonale | Thirrja e parë Dialogu ndërkulturor në art

Ju lutemi lexoni me kujdes udhëzimet para se të plotësoni aplikimin tuaj.

Propozimet që nuk plotësojnë të gjitha kriteret dhe kushtet nuk do të merren parasysh. Në rast të paqartësive ju lutemi dërgoni pyetjet tuaja tek info@swissculturalfund.al përpara se të dorëzoni aplikimin tuaj.

1. Afate të rëndësishme

- Kjo thirrje është e hapur nga data **22 Tetor 2018** deri në datën **5 Janar 2019** ora 00:00.
- Afati për dorëzimin e pyetjeve me shkrim në adresën info@swissculturalfund.al është data **12 Nëntor 2018** ora **12:00**.

2. Perse kjo thirrje?

Në kuadër të fuqizimit të dialogut ndërkufitar dhe rritjes së mirëkuptimit ndërkulturor përmes arteve në Ballkanin Perëndimor, Fondi Kulturor Zviceran në Shqipëri fton organizatat kulturore lokale dhe rajonale që të paraqesin propozime për hartimin dhe zbatimin e një **Programi Rezidence** që thekson këtë aspekt.

Misioni i Fondit Kulturor Zviceran është të sjellë së bashku një grup artistësh të talentuar nga formime të ndryshme dhe vende të rajonit dhe t'u ofrojë atyre hapësira, kohë dhe kontekst për të krijuar një art bashkëpunues që synon të eksplorojë dhe kuptojë marrëdhëniet dhe bashkëjetesën pavarësisht nga tensionet politike.

3. Kush mund të aplikojë?

Aplikimet janë të mirepritura nga organizatat që zbatojnë programe Art Residency, si dhe organizatat, institucionet dhe grupet që punojnë për iniciativa të reja në fushën e arteve dhe kulturës.

Artistët individualë dhe palët e tjera të interesit nuk kanë të drejtë të aplikojnë.

Organizata kulturore ose institucione të artit nga Shqipëria ose rajoni, me përvojë të dëshmuar në organizimin, menaxhimin ose duke qenë pjesë e programeve të mëparshme të Rezidencës.

Ekipet e organizates aplikuese duhet të përbëhen nga:

- Ekspert me aftësi dhe eksperiencë të menaxhimit të projekteve të provuara në fushën kulturore
- Ekspert me eksperiencë të dëshmuar si kujdestare e artit ose menaxher i artit
- Ekspert me njohuri të plotë të artit, komunikimit dhe botimit
- Partnerët nga vendet e tjera të rajonit konsiderohen si një avantazh



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

CBTL | Center for Business
Technology and Leadership

Organizata aplikuese duhet të provojë aftësinë për të tërhequr dhe përfshirë artistë nga të paktën 3 (tre) vende të rajonit (Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina).

4. Kërkesat Teknike për Propozimet

Propozimi për Programin Art Residence duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- **Fusha e interesit: Dialogu ndërkulturor në art** përmes eksplorimit të traditave të përbashkëta, çështjeve sociale ose imagjinatës së një të ardhmeje të mundshme.
- **Vendi i propozuar:** Preferohet Berati, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë ose Tiranë.
- **Kohëzgjatja e propozuar:** mes 2 dhe 4 javë.
- **Disiplina:** Arte vizuale (fotografia, piktura, skulptura, multimedia)
- **Numri i artistëve rezidentë në një kohë:** 6 – 10
- **Grupmosha e pjesëmarrësve:** 25-35 vjet
- **Pjesëmarrja rajonale në program:** Të paktën tre vende nga rajoni përfshirë Shqipërinë. Vendet e pranueshme janë Shqipëria, Maqedonia, Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina

5. Pritshmerite nga organizata implementuese

Organizata implementuese e përzgjedhur nga kjo thirrje pritet të planifikojë, zbatojë dhe dokumentojë tërë programin e reziencës duke siguruar që të përmbushë të gjitha hapat e mëposhtëm:

- Propozimi dhe gjetja një mjedisi inspirues për programin e rezidences. Një mjedis që frymëzon krijimtarinë dhe nxit bashkëpunimin. Një vend që të jetë atraktiv për artistët.
- Krijimi i një plani komunikimi që do të tërheqë aplikime cilësore përmes:
 - Një emri frymëzues për programin
 - Një identitet vizual
 - Një fushatë efikase komunikimi nëpërmjet kanaleve të mediave sociale
- Të shkruajë, planifikojë dhe publikojë një thirrje të hapur për Artist në Rezidencë, përmes kanaleve web, email dhe mediave sociale, tek artistët në të gjitha vendet e lartpërmendura.
- Prezgjedhë 6 deri 10 artistë që përmbushin kriteret e përmendura në kërkesat teknike. Është e rëndësishme të garantohet përfaqësimi nga të paktën 3 (tre) vende.
- Sigurimi i udhëtimit dhe strehimit me pensione të plotë për artistët rezidentë.
- Sigurimi i hapësirave të punës, mjeteve dhe materialeve për pjesëmarrësit.
- Sigurimi i një skeduli të detajuar për të gjithë kohëzgjatjen e Rezidencës.
- Organizimi i prezantimeve dhe klasave në studio me artistë të ftuar, artistë lokalë ose vizitorë nga fusha të ngjashme.
- Organizimi dhe udhëheqja e workshop-ve në grupe gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
- Mentorim, mbikëqyrje dhe ndihmë për artistët pjesëmarrës në krijimin e punimeve të tyre.
- Organizimi i një ekspozitë përfundimtare të rezultateve të programit, të hapura për publikun.
- Dokumentimi i programit përmes fotografisë cilësore, video, web dhe në formë të shkruar.
- Publikimi i një broshure përfundimtare të rezultateve të programit.
- Krijimi i një listë kontaktesh që do t'ju ndihmojë pjesëmarrësi të qëndrojnë në kontakt me organizatën dhe me njëri-tjetrin në të ardhmen.
- Mbajtja e komunikime të shpeshta me Fondin Kulturor Zviceran në Shqipëri përmes raporteve.

6. Propozimi Financiar

Kostot e mëposhtme duhet të jenë pjesë e propozimit të buxhetit

- Udhëtim
- Akomodimi
- Ushqim
- Mjedis i Punes

- Mjetet dhe materialet
- Tarifat e ekspertëve
- Tarifat për folësit e ftuar/mentorët/artistët (nëse është e aplikueshme)
- Udheheqesi/Moderatori i Rezidences (nëse është e aplikueshme)
- Botimi i artikujve të shkurtër në mediat lokale, kombëtare dhe sociale
- Përgatitja e një dokumentari të shkurtër video mbi projektin (5- 10 minuta)
- Projektimi, ueb, fotografimi, botimi, mediat dhe kostot e dokumentacionit
- Kosto Logjistike për ngjarje të tjera (mjedise te tjera per zhvillimin e aktiviteteve)
- Tarifat e menaxhimit
- Çmimet për artistët
- Dieta ditore për artistët
- Përgatitja dhe organizimi i ekspozites përfundimtare

Ju lutem vini re se TVSH nuk është një shpenzim i pranueshëm dhe duhet të mbulohet nga mjete të tjera të financimit.

Kërkesa maksimale për grant nga SCFA është 3.000.000 LEK.

7. Dorezimi i Aplikimeve

Secili aplikant duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

1. Një përshkrim të hollësishëm të propozimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - Titulli i programit të qëndrimit të propozuar
 - Kohëzgjatja
 - Numri i artistëve të përzgjedhur
 - Vendndodhja e propozuar
 - Aktivitetet e propozuara
 - Të ftuar, folës, mentorë, etj.
 - Skeduli i propozuar
 - Rezultatet e pritura
2. Një afat kohor paraprak për zbatimin e projektit
3. Oferta financiare sipas specifikimeve të lartpërmendura
4. Resume të ekspertëve të përfshirë në projekt
5. Dokumentet ligjore që vërtetojnë regjistrimin e organizatës në vendin e origjinës.
6. Dëshmia e kompetencës dhe eksperiencia e mëparshme në aktivitetet përkatëse.

8. Kriteret e vlerësimit

Propozimi fituese do të zgjidhet nga një komision vlerësimi i ekspertëve i përbërë nga një përfaqësues nga Fondi Kulturor Zviceran, Ambasada Zvicerane dhe një ekspert i pavarur, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Kontrolli administrativ
- Cilësia dhe origjinaliteti i propozimit
- Rëndësia e propozimit me temën e interesit
- Formimi dhe eksperiencia e aplikantit
- Efektshmëria e kostove financiare të projektit të propozuar
- Efektshmëria e afatit kohor të projektit të propozuar

9. Afatet e Parashikuara

Afati	Aktivitetet
22/Tetor/2018	Çelja e Thirrjes së pare Rajonale – Publikimi në website-in e SCFA dhe mediat sociale
12/Nëntor/2018	Dorëzimi i pyetjeve me shkrim në adresën info@swissculturalfund.al
22/Nëntor/2018	Publikimi i Përgjigjeve në website-in e SCFA
05/Janar/2019	Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve të plota
15/Janar/2019	Vlerësimi i propozimeve të dorëzuara
25/Janar/2019	Negociatat (të rezervuara), përfshirë intervistat (nëse është e nevojshme) me ekspertin kryesor të atyre ofertuesve që ende kanë një shans për të fituar
31/Janar/2019	Marrja e vendimit në baze të vlerësimeve
02/Shkurt/2019	Komunikimi i vendimit për të gjithë pjesëmarrësit me propozime
09/Shkurt/2019	Nënshkrimi i kontratës me projektin fitues
19/Shkurt/2019	Data e parashikuar për fillimin e Projektit
05/Prill/2019	Data e parashikuar për përfundimin e Projektit